



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



Prishtinë, 27 janar 2023  
Kodi i ZRRE-së: V\_1667\_2023

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale Nr. 01078-0 ZK Sllatinë e Madhe me kapacitet të instaluar prej **38.72 kW** në Komunën e Fushë Kosovës, e pranuar me datë 19.01.2023 nga aplikuesi personi juridik "SANTEFARM"SH.P.K., me adresë: fsh. "Sllatinë e Madhe" Komuna e Fushë Kosovës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 27 janar 2023 nxori këtë:

## **V E N D I M**

### **PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit "SANTEFARM"SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale Nr. 01078-0 ZK Sllatinë e Madhe me kapacitet të instaluar prej **38.72 kW** në Komunën e Fushë Kosovës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "SANTEFARM"SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPR - 90138905 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi "SANTEFARM"SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me Nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

## **A r s y e t i m**




- o ZRRE, me datë 19.01.2023 nga aplikuesi "SANTEFARM"SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, që do të vendosen në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale Nr. 01078-0 ZK Sllatinë e Madhe me kapacitet të instaluar prej 38.72 kW në Komunën e Fushë Kosovës.
  - o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergetik Nr. 12487 të datës 30.11.2022 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin 05 Nr. 15 të datës 18.01.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikim Urban Komunes së Fushë Kosovës.
  - o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "SANTEFARM"SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike që do të vendosen në kulmin e objektit në kulmin e objektit në ngastrën kadastrale Nr. 01078-0 ZK Sllatinë e Madhe me kapacitet të instaluar prej 38.72 kW në Komunën e Fushë Kosovës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Fushë Kosovës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Selman Hoti, anëtar

  
Izet Rushiti, anëtar

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Gani Buçaj, anëtar